



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2021:144420
Datë: 29.11.2024
Numri i dokumentit: 06523418

Kom.Dh.Shk.II.nr.1692/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Dren Rogova, kryetar, Faton Bajrami dhe Krenar Berisha, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Agona Pizzeria” SH.P.K., me seli në rr. “Bastri Beqiri” p.nr., Komuna e Vushtrrisë, kundër të paditurit KESCO – Departamenti për Konsumator – Sektori i Rikthimit të Humbjeve, me seli në Prishtinë, me bazë juridike: anulim i aktit administrativ – përkatësisht anulimi i Vendimit 2532909 të datës 24.05.2021, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.728/22 të datës 19.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.11.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit “Agona Pizzeria” SH.P.K., me seli në Vushtri, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.728/22 të datës 19.07.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Administrative, (tani e tutje: “Gjykata e shkallës së parë”), me Aktvendimin KA.nr.728/22 të datës 19.07.2024, (tani e tutje: “aktvendimi i ankimuar”), ka hedhur poshtë padinë e paditësit “Agona Pizzeria” SH.P.K., me seli në rr. “Bastri Beqiri” p.nr., Komuna e Vushtrrisë, (tani e tutje: “paditësi”), me të cilën ka kërkuar që të anulohet Vendimi 2532909 i datës 24.05.2021, (tani e tutje: “akti i kontestuar administrativ”), të të paditurit KESCO – Departamenti për Konsumator – Sektori i Rikthimit të Humbjeve SH.A., me seli në Prishtinë, (tani e tutje: “i padituri” apo “KESCO”), për rikthimin e humbjeve.

Kundër këtij aktvendimi me datë 08.08.2024 pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, (tani e tutje: “Gjykata e shkallës së dytë”), ka ushtruar ankesë paditësi, për

shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Përmes kësaj ankesë paditësi i ka propozuar Gjykatës së shkallës së dytë që t'a aprovojë ankesën e paditësit si të bazuar ashtu që t'a aprovojë në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe t'a detyrojë të paditurin për anulimin e aktit të kontestuar administrativ.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar i padituri.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, si gjykatë e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore në kuptim të nenit 12 të Ligjit Nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, nenit 49 dhe 63 të LKA-së, si dhe nenit 194 të LPK-së, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës vlerësoi se:

- Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi pranë Gjykatës së shkallës së parë me datë 05.07.2021 ka inicuar konflikt administrativ me kërkesë që të anulohet akti i kontestuar administrativ i të paditurit për rikthimin e humbjes. Meqenëse padia kishte të meta, ku ndër të tjera në të mungonte edhe kopja e aktit të kontestuar administrativ, Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin procedural të datës 31.05.2024 e ka ftuar paditësin që ta korrigojë padinë, ashtu që të tregojë cilin akt administrativ e ka goditur me padi dhe në çfarë vëllimi propozon anulimin e këtij akti administrativ, si dhe Gjykatës së shkallës së parë t'i dërgojë tri kopje të këtij akti të kontestuar administrativ. Përmes këtij aktvendimi procedural, njëherazi Gjykata e shkallës së parë ka paralajmëruar paditësin se nëse nuk i mënjanon këto të meta të padisë brenda afatit prej 8 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi procedural, Gjykata e shkallës së parë do ta hedhë poshtë padinë në kuptim të nenit 33, para. 2 të LKA-së.

Pas pranimi të Aktvendimit procedural të datës 31.05.2024 nga paditësi me datë 06.06.2024, paditësi përmes parashtrësës së datës 13.06.2024 ka deklaruar/precizuar se kërkon anulimin e tërësishëm të Vendimit 2532909 të datës 24.05.2021 të nxjerrë nga i padituri, përkatësisht anulimin e tërësishëm të aktit të kontestuar administrativ. Megjithatë, Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se paditësi nuk i ka dorëzuar gjykatës këtë akt të kontestuar administrativ. Për më tepër, Gjykata e shkallës së dytë ka gjetur se paditësi në këtë parashtrësë nuk i ka paraqitur gjykatës ndonjë rrethanë që e ka penguar atë në dërgimin e aktit të kontestuar administrativ gjykatës. Përveç kësaj, Gjykata e shkallës së parë ka vërejtur se akti i kontestuar administrativ nuk ka bërë pjesë në shkresat e lëndës, të dorëzuara me padi ose përmes parashtrësave tjera të paditësit.

Duke marrë parasysh këto, me theks të veçantë mosdorëzimin e aktit të kontestuar administrativ gjykatës, Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se paditësi për plotësim/precizimin e padisë nuk ka respektuar afatin 8 ditësh sikurse cekur në mënyrë shprehimore edhe në Aktvendimin

procedural të datës 31.05.2024. Dhe si rrjedhojë e kësaj, Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se janë plotësuar prezumimet procedurale për zbatimin e nenit 33, para. 2 të LKA-së.

Më tutje, Gjykata e shkallës së parë e ka vlerësuar si të arsyeshme sqarimin e asaj se është fakt notor që i padituri, përkatësisht KESCO, nuk është organ administrativ në kuptim të nenit 3, para. 1, nën-para. 1 të LKA-së, por është shoqëri tregtare e regjistruar pranë ARBK-së me emërtimin “Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike” SH.A., dhe me NUI: 810799364. Si rrjedhojë e kësaj, sipas vlerësimit të Gjykatës së shkallës së parë veprimet e të paditurit nuk paraqesin akte administrative në kuptim të nenit 3, para. 1, nën-para. 2 të LKA-së. Megjithatë, Gjykata e shkallës së parë ka konsideruar se, duke mos e pasur në shkresat e lëndës aktin e kontestuar administrativ, e ka pasur të pamundur të shqyrtojë saktë në qoftë se vendimi në fjalë i të padiurit paraqet akt administrativ apo jo.

Kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, duke u nisur nga gjendja e këtillë e kësaj çështje juridike administrative, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e Gjykatës së shkallës së parë. Sipas vlerësimit të Kolegjit, Gjykata e shkallës së parë fillimisht në mënyrë të saktë ka gjetur të metat e padisë së paditësit në kuptim të nenit 30, para. 1 të LKA-së, dhe më pastaj përmes Aktvendimit procedural të datës 31.05.2024 në mënyrë të qartë e ka udhëzuar paditësin për mënjanimin e këtyre të metave në padinë e tij, duke e njoftuar atë që mosmënjanimi i këtyre të metave në padi si pasojë juridike ka hedhjen poshtë të padisë – veprim procedural ky i Gjykatës së shkallës së parë që ka qenë në përputhje të plotë me nenin 33, para. 1 të LKA-së. Më pastaj, pas kalimit të afatit procedural 8 ditore të paditësit për mënjanimin e të metave në fjalë, Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të saktë ka vlerësuar se janë plotësuar prezumimet procedurale për zbatimin e nenit 33, para. 2 të LKA-së, që njëherazi paraqet edhe bazë juridike të saktë të aktvendimit të ankimuar.

Neni 30, para. 1 i LKA-së thekson: *“Në padi duhen të përfshihen: emërtimi i gjykatës të cilës i paraqitet padia, emri, mbiemri dhe vendbanimi, respektivisht selia e paditësit dhe e të paditurit, akti administrativ kundër të cilit është drejtuar padia, arsyet pse ngrihet padia, si dhe në cilin drejtim dhe vëllim propozohet anulimi i aktit administrativ. Bashkë me padinë duhet të bashkangjitet akti që kontestohet në origjinal ose kopje”.*

Neni 33, para. 1 i LKA-së thekson: *“Nëse padia nuk është e plotë, është e pakuptueshme ose ka të meta, kryetari i kolegjit do të ftojë paditësin, që brenda afatit prej tetë (8) ditëve t’i mënjanojë të metat e padisë. Në ftesë duhet të ceken udhëzimet për të mënjанuar të metat e padisë dhe paralajmërimi për pasojat që do të lindin nëse nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës”.*

Neni 33, para. 2 i LKA-së thekson: *“Nëse paditësi, brenda afatit të cekur, nuk i mënjanon të metat e padisë, kurse ato janë të atilla që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata do ta hedhë poshtë me vendim padinë, nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm”.*

Për më tepër, Gjykata ankimore në mesin e shkresave të lëndës gjeti një kopje të faturës me nr. ref. 2532909/MG T15BI të datës 24.05.2021 të lëshuar nga i padituri KESCO, dhe vlerësoi se kjo faturë edhe pse ka të dhëna të përafërta me Vendimin 2532909 të datës 10.12.2020 – vendim ky i kontestuar nga paditësi si akt administrativ, të cilin nuk i'a ka dorëzuar sikurse Gjykatës së shkallës së parë, po ashtu edhe Gjykatës së shkallës së dytë në këtë konflikt administrativ, i njëjti nuk mund të kualifikohet si veprim administrativ në kuptim të nenit 3, para. 1 të LPPA-së dhe aq më pak si akt administrativ në kuptim të nenit 44, para. 1 të LPPA-së dhe nenit 3, para. 1, nën-para. 1.2 të LKA-së. Prandaj, Gjykata e shkallës së dytë gjeti se sikurse kjo faturë, sikurse edhe dokumentet e tjera të gjendura në shkresat e lëndës të kësaj çështje juridike administrative, nuk kualifikohen si veprime administrative apo akte administrative që të mund të paraqesin objekt shqyrtimi të një konflikti administrativ në kuptim të nenit 13, para. 1 të LKA-së.

Neni 3, para. 1, nën-para. 1.2 i LKA-së thekson: *“Akt administrativ - çdo vendim të organit të paraparë në nën-paragrafin 1.1. të këtij paragrafi, i cili merret në fund të një procedure administrative në ushtrimin e autorizimeve publike dhe që prek, në mënyrë të favorshme ose jo të favorshme të drejtat e njohura ligjërish, liritë ose interesat e personave fizikë ose juridikë përkatësisht palës tjetër në vendosjen e çështjes administrative”*.

Neni 13, para. 1 i LKA-së thekson: *“Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative ...”*.

Në vazhden e kësaj, Kolegji i kësaj gjykate vlerësoi se hedhja poshtë e padisë në këtë konflikt administrativ nga ana e Gjykatës së shkallës së parë, përmes aktvendimit të ankimuar si rrjedhojë e mospërbushjes së prezumimeve procedurale për padinë e rregullt dhe të pranueshme, përkundër udhëzimeve të qarta dhe të sakta të dhëna nga ana e Gjykatës së shkallës së parë, paraqet një vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Më tutje, hedhja poshtë e padisë, si rrjedhojë e mospërbushjes së prezumimeve procedurale apo si rrjedhojë e mospërmirësimit të të metave esenciale në të përbrenda afatit ligjor, konsiston në një veprim të drejtë gjyqësor që përkon me frymën e drejtshmërisë dhe efikasitetit gjyqësor. Prandaj, Gjykata e shkallës së parë, duke zbatuar normat juridiko-procedurale të natyrës imperative të cituara më lartë, ka vepruar drejtë. Për më tepër, Gjykata e shkallës së parë, duke mos u lëshuar fare në gjykimin meritore të kësaj çështje juridike administrative dhe duke hedhur poshtë padinë e paplotë dhe me të meta esenciale, assesi nuk ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit apo edhe të drejtën e tij për t'u shërbyer me drejtësi nga gjykata kompetente.

Mbi natyrën imperative të parakushtit themelor procedural të rregullsisë dhe plotësisë së padisë, anashkalimi i të cilit e bënë të papranueshme padinë, Gjykata ankimore në kuptim të nenit 53 të Kushtetutës së Kosovës thirret në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njerit:

Nw vendimin e GjEDNJ-së të datës 28.10.1998 në rastin Pérez de Rada Cavanilles k. Spanjës” (116/1997/900/1112) par.44, GJEDNJ përcakton se: *“Më tej, është e qartë nga praktika*

gjqësore e Gjykatës se “e drejta për një gjykatë”, një aspekt i së cilës është e drejta e qasjes, nuk është absolute; ajo i nënshtrohet kufizimeve të lejuara në mënyrë të nënkuptuar, veçanërisht kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, pasi nga vetë natyra e tij kërkon rregullim nga shteti, i cili gëzon një kufi të caktuar vlerësimi në këtë drejtim.”.

Si përfundim, duke pasur parasysh vlerësimet e mësipërme, Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale konstatuan se pretendimet ankimore të paditësit paraqesin pretendime ankimore të pabazuara. Si rrjedhojë e kësaj, Gjykata ankimore vlerëson se Gjykata e shkallës së parë ka vepruar në mënyrë të saktë dhe të ligjshme në këtë konflikt administrativ.

Nga të lartëcekurat, Gjykata e shkallës së dytë në këtë konflikt administrativ vendosi si në dispozitiv të aktvendimit dhe atë në bazë të nenit 209, pika b), të ndërlidhur me nenin 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.1692/24, me datë 27.11.2024

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova